

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtaren Anita Krasniqi Prenaj, me sekretaren juridike Fexhrie Tashevci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.II.nr.2557/17, të datës 16.03.2018, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 24.04.2018, mori:

**A K T G J Y K I M**

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2557/17, të datës 16.03.2018, gjykata jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**I akuzuari:**

**F.M.** nga i ati F., i lindur me datë ..., me nr. ID ..., me vendbanim në fshatin S. Komuna e V., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 21.04.2017, rreth orës 12:20, në rrugën Prishtinë Ferizaj, respektivisht në C., te Pompa e derivateve “ RT P. “, i pandehuri F.M., gjatë lëvizjes me automjetin e tij “ VW Caddy “ ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik ka rrezikuar jetën e njeriut dhe pasurinë, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me nenin 33 dhe 48 të Ligjit për Sigurinë në komunikacionin rrugor, duke mos respektuar rregullat e qarkullimit në komunikacion si dhe shenjat e trafikut, ndërmer veprimin e ndërrimit të kahjes së lëvizjes nga ana e majtë në atë të djathtë të rrugës, me ç’rast pengon lëvizjen e lirë të automjetit “ VW Caddy “ ngjyrë hiri me targa ..., të cilin e ngiste tani i dëmtuari A.B., i cili nga parkingu i pompës “ RT Petroll “, ishte kyçur në shiritin e djathtë të rrugës, kështu i pandehuri në pamundësi të shmangies se aksidentit me pjesën e parë të djathtë të automjetit, godet në pjesën e përparme të majtë automjetin e të dëmtuarit, me ç’rast, shkaktohet aksidenti i komunikacionit ku pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore kanë pësuar A.B. dhe bashkudhëtari i tij G.S.:-

- **Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

**DËNIM ME GJOBË**

I akuzuari F.M. dënohet me gjobë në shumë prej **200€ ( dy qindë euro)**, të cilën mund ta paguaj me dy (2) këste mujore në afatin ligjor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20€ të gjobës.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale për ekspertizën mjeko ligjore në shumë prej 20,00€, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88€ si dhe paushallin gjyqësor shumë prej 20€, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasuroro – juridike, udhëzohen në kontest juridiko – civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.2557/17, të dt.16.03.2018 ka akuzuar F.M., se ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor, Dr. N.H, dt. 28.01.2018 dhe ekspertiza e ekspertit të komunikacionit rrugor ing. i Diplomuar R.B. dt. 16.11.2017, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK-së.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË P.nr.1451/18, të datës 24.04.2018**

**Sekretarja Juridike  
Fexhrie Tashevc**

**G j y q t a r j a  
Anita Krasniqi Prenaj**

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.